

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“BLACK DIAMOND HOTEL” Sh.p.k

Sot , me date 25.11.2021 , ne qytetin e Tiranes, shoqeria e meposhtme:

“NAZERI 2000” shpk, me adrese kryesore, Rruga”Kavajes”, Condor Center, Tirane paisur me NIPT K31422029Q me ortak te vetem Z. Durim Nazeraj dhe Administrator z. Alfred Zylalaj.

Vendos te nenshkruaje kete Akt Themelimi per krijimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “**BLACK DIAMOND HOTEL**” Sh.p.k. Aktiviteti i seciles rregullohet nga ky Akt Themelimi dhe Statuti duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Neni 1

EMERTIMI

1. Shoqeria do te emertohet “**BLACK DIAMOND HOTEL**” Sh.p.k. Ky emertim do te jete i stampuar ne vulen e saj dhe me te cilin do te paraqitet ne cdo dokumentacion me te tretet.
2. Ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe do te dalin nga shoqeria, emertimi i saj do te shoqerohet edhe me inicialet “Sh.p.k”, shuma e Kapitali Themeltar si dhe Selia Qendrore.

Neni 2

SELIA

1. Selia qendrore e shoqerise “**BLACK DIAMOND HOTEL**” Sh.p.k, ndodhet ne qytetin e Tiranes, Sheshi Selvia, Rruga Siri Kodra, 1005 Tirana, Njesia bashkiake Nr.9.

Neni 3

KOHEZGJATJA

1. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise “**BLACK DIAMOND HOTEL**” Sh.p.k do te jete pa afat.

Neni 4

OBJEKTI

1. Objekti i aktivitetit te shoqerise do te jete:

Hoteleri, Bar, Restorant, Katering, Salle konferencash, Spa Center, Ushtrimi I veprimtarise turistike si tour - operator, si agjensi turistike, udhetimi te transportit per udhetare, guide, perkthyes dhe paisjet ndihmese, turizem, makina me qera, ambiente me qera, parking, parukeri, estetike. Ushtrimi i veprimtarise per shitje bileta te te gjitha llojeve te transportit ajror, detar, tokesor, hekurudhor si dhe te gjitha sherbimet e tjera qe perfshihen ne HOTELERI.

Neni 5

Kapitali Themeltar

1. Kapitali Themeltar i shoqerise “**BLACK DIAMOND HOTEL**” Sh.p.k eshte 100,000 Leke.
2. Kapitali i shoqerise ndahet, ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga ortaku ne shoqeri, ku ortaku zoteron nje kuote te vetme. Kuote kjo e shlyer teresisht nga ortaku dhe e ndare si me poshte:
 - “**NAZERI 2000**” shpk, 1 kuote me perqindje ne pjesemarrje 100, me vlerë nominale 100,000 leke, qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.



Neni 6

Kontributet dhe kuotat

1. "NAZERI 2000" shpk, me adrese kryesore, Rruga "Kavajes", Condor Center, Tirane paisur me NIPT K31422029Q me ortak te vetem Z. Durim Nazeraj dhe Administrator z. Alfred Zylalaj do te ofroj nje kontribut ne para te barabarte me 100 % te kapitalit fillestar, prej 100,000 (njqind mije) leke.
2. Kontributi i ortakut si me siper,do te jete ne para dhe do depozitohet ne nje llogari bankare te hapur ne emer te shoqerise "BLACK DIAMOND HOTEL" Sh.p.k, brenda 10 diteve.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar e te drejta qe rrjedhin prej tyre, mund te transferohen sipas procedurave te parashikuara ne ligj dhe ne Statutin e shoqerise.

Neni 8

Organi vendimmarres

1. Asambleja e Ortakeve eshte i vetmi organ vendimmarres i shoqerise.
2. Vendimet e Asamblese se Zakonshme dhe te jashtezakonshme, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte ose e kualifikuar, jane te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne me shume se 51% te te gjitha Kapitalit Themeltar.
3. Vendimet qe merr kjo asamble me shumice votash, jane te detyrueshme per ortaket qe mungojne ose qe kane mendim te kundert. Ortaket kane te drejten e ankimit, te cilin mund ta ushtrojne ne rastet, kohen dhe format qe lejon ligji.

Neni 9

Administrimi

1. Shoqeria administrohet nga te pakten nje administrator dhe maksimumi tre administrator, te cilet mund te jene dhe jo ortak dhe emerohen e shkarkohen nga Asambleja e Ortakeve.
2. Administratori/et qendrojne ne postin e tyre per nje periudhe maksimumi 5 vite financiare, me mundesine per tu rizjedhur.
3. Administratori eshte perfaqesuesi ligjor i shoqerise dhe kompetencat e tije jane te kufizuara si me poshte: Administratori i shoqerise nuk ka te drejte te lidhe kontrate me subjektet e tjera pa kunderfirmen e Ortakut te vetem. Nuk ka te drejte te nenshkruaje Çeqe, kambiale bankare etj, pa kunderfirmen e ortakut te vetem. Nuk ka te drejte te perfaqesoj shoqerine tek te tretet pa qene i pajisur me autorizim ose prokure te posaçme nga ortaku i vetem. Nga ana e Bankes duhet te kryhen transferta vetem nese ato do te kene bashkengjitur autorizim nga ortaku i vetem. Personi i vetem i autorizuar i shoqerise per te kryer teheqje (Cash) te vlerave monetare dhe cdo veprim tjeter nga te gjitha llogarite bankare te shoqerise, pa asnje kufizim do te jete ortaku i vetem i saj Z. Durim Nazeraj.
4. Administratori i pare i shoqerise eshte Znj. Bela Meleqi, me numer identifikimi: J76013045A

Neni 10

Gjuha

1. Ky Akt Themelimi eshte i perbere ne 4 kopje, ne gjuhen shqipe qe kane vlere te njejte ligjore.

ORTAKU I SHOQERISE "BLACK DIAMOND HOTEL" Sh.p.k

NAZERI 2000

ADMINISTRATOR

ALFRED ZYLALAJ

